| €, të cilat sigurohen si furnizim me mjete dhe pajisje të parapara në planin e aprovuar të biznesit.<br><br>11. Nga programi i vetëpunësimit, mund të përfitojë vetëm njëri nga anëtarët e familjes së riatdhesuar.<br><br>12. Monitorimi dhe vlerësimi periodik i bizneseve të financuara nga buxheti i riintegrimit bëhet nga ekipi i përbërë nga DRPR dhe MPMS/APRK deri në tetëmbëdhjetë (18) muaj pas financimit të biznesit.<br><br>13. Shërbimet e konsulencës për zhvillimin e bizneseve ofrohen për përfituesit e skemës së vetëpunësimit deri në 12 muaj pas pranim-dorëzimit të mjeteve të punës.<br><br>14. Për integrimin e personave të riatdhesuar në tregun e punës, përmes masave aktive të tregut të punës, përkujdeset MPMS/APRK, bazuar në mandatin e përcaktuar me legjislacionin në fuqi. | (3000) € and shall be provided in the form of tools and equipment foreseen in the approved business plan.<br><br>11. Only one member of the repatriated family may benefit from the self-employment program.<br><br>12. Businesses funded from the reintegration budget shall be monitored and periodically assessed by a team composed of DRRP and MLW/EARK up to eighteen (18) months after funding of the business.<br><br>13. Consultancy services for business development shall be provided to beneficiaries of the self-employment scheme for up to 12 months after delivery of work tools.<br>14. MLW /EARK shall be responsible for the integration of repatriated persons in the labour market through the Active Labour Market Measures, based on the mandate determined by the applicable legislation. | obezbeđuje kao nabavka predviđenih sredstava u usvojenom biznis planu.<br><br>11. Iz programa samozapošljavanja može imati korist samo jedan od repatriranih članova porodice.<br><br>12. Periodično praćenje i procenjivanje preduzeća vrši se od ekipe koja se sastavljena od DRRL-a i MRSZ / AZRK i do osamnaest (18) meseci nakon finansiranja preduzeća.<br><br>13. Savetodavne usluge za razvoj preduzeća se pružaju za korisnike šeme samozapošljavanja do 12 meseci nakon primopredaje sredstava za rad.<br><br>14. Za integraciju repatriranih lica u tržište rada, putem aktivnih mera tržišta rada, brine se MRSZ /AZRK na osnovu mandata utvrđenog važećim zakonodavstvom. |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 29**<br>**Mbështetja me grante bujqësore**<br><br>1. Personat e riatdhesuar mund të përfitojnë grante bujqësore të cilat ofrohen nga MBPZHR bazuar në kriteret dhe procedurat e parapara me legjislacionin në fuqi.<br><br>2. Personat e riatdhesuar mund të përfitojnë materiale dhe mjete bujqësore të cilat ofrohen nga drejtoria përkatëse komunale bazuar në kriteret dhe procedurat e parapara me legjislacionin në fuqi.<br><br>3. MBPZHR në bashkëpunim me MPB/DRPR do të zhvillojë procedurat e nevojshme për sigurimin e qasjes në grantet bujqësore për personat e riatdhesuar në zonat rurale. | **Article 29**<br>**Support with agricultural grants**<br><br>1. Repatriated persons may benefit agricultural grants provided by MAFRD based on the criteria and procedures provided for in the legislation in force.<br><br>2. Repatriated persons may benefit agricultural materials and means provided by the relevant municipal department based on the criteria and procedures provided for in the legislation in force.<br><br>3. MAFRD, in cooperation with MIA/DRRP, shall conduct the necessary procedures to ensure access to agricultural grants for repatriated persons in rural areas. | **Član 29**<br>**Podrška uz poljoprivredne grantove**<br><br>1. Repatrirana lica mogu dobiti poljoprivredne grantove koje pruža MPŠRR na osnovu kriterijuma i procedura predviđenih važećim zakonodavstvom.<br><br>2. Repatrirana lica mogu dobiti poljoprivredni materijala i opremu koje pruža relevantno opštinsko odeljenje na osnovu kriterijuma i procedura predviđenih važećim zakonodavstvom.<br><br>3. MPŠRR će u saradnji sa MUP/ DRRL-om sprovoditi potrebne procedure za obezbeđivanje pristupa poljoprivrednim grantovima za repatrirana lica iz ruralnih područja. |
| **Neni 30**<br>**Rindërtimi ose renovimi i shtëpive**<br><br>1. Personat e riatdhesuar mund të përfitojnë renovim dhe/ose rindërtim të shtëpive të tyre nëse kanë jetuar jashtë Kosovës së paku pesë (5) vite pa ndërprerë.<br><br>2. Personat e riatdhesuar përfitojnë renovim dhe/ose rindërtim të shtëpive nëse ata dëshmojnë se shtëpia e tyre në të cilën ata | **Article 30**<br>**Reconstruction or renovation of houses**<br><br>1. Repatriated persons may benefit renovation and/or reconstruction of their houses if they have lived outside Kosovo for an uninterrupted period of at least five (5) years.<br><br>2. Repatriated persons shall benefit renovation and/or reconstruction of their houses if they prove that their house, in | **Član 30**<br>**Rekonstrukcija ili renoviranje kuća**<br><br>1. Repatrirana lica mogu dobiti renoviranje i/ili rekonstrukciju njihovih kuća, ako su živela van Kosova najmanje pet (5) godina bez prekida.<br><br>2. Repatrirana lica dobijaju renoviranje i/ili rekonstrukciju kuće ako dokažu da je njihova |

| | | |
|---|---|---|
| kanë jetuar para emigrimit është plotësisht ose pjesërisht e shkatërruar.<br><br>3. Personat e riatdhesuar, për përfitim të rindërtimit të shtëpisë, duhet të pajisen me leje ndërtimi nga Drejtoria e Urbanizmit, e cila i prezantohet KKR-së për vendimmarrje.<br><br>4. Personat e riatdhesuar, të cilët kanë qenë përfitues të kësaj skeme nga ndonjë program në fushën e rindërtimit dhe/ose rinovimit, nuk kanë të drejtë në këtë ndihmë.<br><br>5. Dokumentet e nevojshme për shqyrtimin e kërkesës janë: dokumentet që dëshmojnë pronësinë, dokumentet e dëmtimeve ose shkatërrimeve të pronës, si dhe pëlqimi i komunës për renovim apo leja ndërtimore për rindërtim edhe vërtetimi se nuk është përfitues i ndonjë programi të mëhershëm për këtë qëllim duhet t'i bashkëngjiten kërkesës.<br><br>6. Verifikimi i gjendjes së shtëpisë dhe klasifikimi i saj në rindërtim apo renovim realizohet në terren nga Drejtoria e Urbanizmit e komunës përkatëse.<br><br>7. Kushtet dhe klasifikimi për renovim dhe rindërtim janë të përcaktuara në shtojcën I të kësaj rregulloreje. | which they have lived before emigration, has been fully or partially destructed.<br><br>3. Repatriated persons, in order to benefit for reconstruction of the house, shall obtain the construction permit from the Urbanisation Department and present the same to the MRC for decision-making.<br><br>4. Repatriated persons, who have benefited from this scheme from any programme in the field of reconstruction and/or renovation, shall not be entitled to this assistance.<br><br>5. Documents necessary for reviewing the request shall be: documents proving ownership, documents of property damages or destructions, as well as the consent of municipality for renovation or permit for renovation and the confirmation that he/she has not benefited from an earlier program for this purpose, and all shall be attached to the request.<br><br>6. The verification of the condition of the house,and its categorization for reconstruction or renovation, is done on-site by the Urbanism Department of the respective municipality.<br>7. Conditions and classification for renovation and reconstruction ardetermined under Annex I of this Regulation. | kuća u kojoj su živeli pre emigracije potpuno ili delimično uništena.<br><br>3. Da bi dobili rekonstrukciju kuće, repatrirana lica treba da obezbeđuju građevinsku dozvolu od Direkcije za urbanizam, koja se predstavlja OKR-u za odlučivanje.<br><br>4. Repatrirana lica koja su bila korisnica ove šeme od bilo kog programu u oblasti rekonstrukcije i/ili renoviranja nemaju pravo na ovu pomoć.<br><br>5.Potrebni dokumenti za razmatranje zahteva su: dokumenta koja dokazuju vlasništvo, dokumenti oštećenja ili uništenja imovine, kao i saglasnost opštine za renoviranje ili građevinska dozvola za rekonstrukciju i dokaz da nije korisnik nekog ranijeg programa u ovom cilju, .<br><br>6. Provera stanja kuće i njena klasifikacija u rekonstrukciju ili renoviranje na terenu vrši Dirkecija za urbanizam dotične opštine.<br><br>7. Uslovi i klasifikacija za renoviranje i rekonstrukciju utvrđeni su u Aneksu I ove Uredbe. |

| | | |
|---|---|---|
| 8. Pranim - dorëzimi i shtëpisë së rindërtuar apo rinovuar bëhet përmes marrëveshjes me shkrim në mes të përfituesit, përfaqësuesit të komunës dhe përfaqësuesit të MEA. | 8. Reconstructed or renovated house shall be handed over through a written agreement between the beneficiary, representative of the municipality and representative of MEE. | 8. Primopredaja renovirane ili rekonstruisane kuće vrši se kroz pismeni dogovor između korisnika, predstavnika opštine i predstavnika MEŽS. |
| **Neni 31**<br>**Pakoja e orendive shtëpiake** | **Article 31**<br>**Household furniture package** | **Član 31**<br>**Paket kućnog nameštaja** |
| 1. Pakoja e orendive shtëpiake ofrohet për personat ose familjet e riatdhesuara nëse konstatohet se atyre iu mungojnë orenditë dhe për shkak të kushteve të vështira ekonomike nuk mund t'i sigurojnë vetë. | 1. Household furniture package shall be provided to repatriated persons or families if ascertained that they lack furniture and due to their difficult economic conditions, they cannot acquire them by themselves. | 1. Paket kućnog nameštaja se pruža za repatrirana lica ako se utvrdi da njima nedostaje nameštaj i zbog teških ekonomskih i socijalnih uslova ne mogu da sami obezbeđuju. |
| 2. Përfituesit e rindërtimit përfitojnë njëkohësisht edhe pakon e orendive shtëpiake. | 2. Beneficiaries of reconstruction shall simultaneously be provided with household furniture package. | 2. Korisnici rekonstrukcije dobijaju istovremeno i paket kućnog nameštaja. |
| 3. Pakoja e orendive ofrohet vetëm njëherë. Përmbajtja e pakos së orendive është e përcaktuar në shtojcën 2 të kësaj rregulloreje. | 3. Furniture package shall be provided only once. The content of the furniture package shall be determined in Annex 2 of this Regulation. | 3. Paket nameštaja se pruža samo jednom. Sadržaj paketa nameštaja je utvrđen u Aneksu 2 ove uredbe. |
| 4. Vlera e pakos së orendive shtëpiake për familjet e riatdhesuara nuk kalon shumën prej dymijë (2000) €, kurse për personat individual nuk kalon shumën prej njëmijë (1000)€. | 4. Value of household furniture package for repatriated families shall not exceed the amount of two thousand (2000) €, whereas for individual persons shall not exceed the amount of one thousand (1000) €. | 4.Vrednost paketa kućnog nameštaja za repatrirane porodice ne prelazi iznos od dve hiljade (2000) €, a za pojedince ne prelazi iznos od hiljadu (1000) €. |

| Neni 32<br>**Mbështetja psiko-sociale** | Article 32<br>**Psycho-social support** | Član 32<br>**Psiho-socijalna podrška** |
|---|---|---|
| 1. Mbështetja psiko-sociale sigurohet për personat e riatdhesuar të cilët vuajnë nga pasojat e përjetimeve traumatike, çrregullimet e shëndetit mendor, si dhe personat që shfaqin probleme të adaptimit dhe përshtatjes pas kthimit. | 1. Psycho-social support shall be provided to repatriated persons suffering consequences of traumatic experiences, mental health disorders, as well as persons with problems of adaptation upon return. | 1. Psiho-socijalna podrška obezbeđuje se repatriranim licima koje pate od posledica traumatičnih doživljaja, poremećaja mentalnog zdravlja, kao i licima sa problemima sa adaptacijom i prilagođavanjem nakon povratka. |
| 2. Mbështetja psiko-sociale adreson dhe trajtojë nevojat psikologjike edhe sociale të individit dhe familjes së riatdhesuar, më qëllim që të lehtësojnë riaktivizimin e aftësive të vetë-mbajtjes dhe tejkalimin e problemeve të përshtatjes. | 2. Psycho-social support shall address and treat psychological and social needs of the repatriated individual and family in order to facilitate reactivation of self-sufficiency skills and overcoming adaptation problems. | 2. Psiho-socijalna podrška rešava i tretira psihološke i socijalne potrebe repatriranog pojedinca i porodice, u cilju olakšavanja reaktivacija sposobnosti samoodrživosti i prevazilaženja problema sa prilagođavanjem. |
| 3. Natyra e mbështetjes psiko-sociale përcaktohet nga specialistët përkatës të shëndetit mendor, në bazë të vlerësimit të nevojave individuale të secilit rast. | 3. Nature of psycho-social support shall be determined by relevant mental health specialists based on the assessment of individual needs of each case. | 3. Priroda psiho-socijalne podrške utvrđuje se od strane relevantnih specijalista za mentalno zdravlje, na osnovu procene individualnih potreba svakog slučaja. |
| 4. Personat në nevojë për mbështetje psiko - sociale referohen te institucionet përkatëse shëndetësore dhe organizatat e specializuara për mbështetje psiko sociale. | 4. Persons in need of psycho-social support shall be referred to relevant health institutions and organizations specialized for psycho-social support. | 4. Lica kojima je potrebna psiho-socijalna podrška upućuju se u relevantne zdravstvene ustanove i specijalizovane organizacije za psiho-socijalnu podršku. |
| 5. MSH në bashkëpunim të ngushtë me MPB/DRPR përgatisin udhëzues të veçantë për standardet e mbështetjes psiko – sociale të personave të riatdhesuar. | 5. MoH, in close cooperation with MIA/DRRP, shall prepare special guidelines for psycho-social support standards of repatriated persons. | 5. MZ u bliskoj saradnji sa MUP/DRRL pripremaju posebne vodiče za standarde psiho-socijalne podrške za repatrirana lica. |

| Neni 33<br>Ndihma dhe mbështetja e personave të cenueshëm | Article 33<br>Assistance and support for vulnerable persons | Član 33<br>Pomoć i podrška ugroženim licima |
|---|---|---|
| 1. Gjatë procesit të riintegrimit të personave të riatdhesuar, vëmendje e posaçme do t'u kushtohet personave të cenueshëm si në vijim: | . 1. During the process of reintegration of repatriated persons, special attention shall be paid to vulnerable persons, as follows: | 1.Tokom procesa reintegracije repatriranih lica posebna pažnja će biti posvećena ugroženim licima kao u nastavku: |
| 1.1. fëmijët pa përkujdesje prindërore; | 1.1.children without parental care; | 1.1. deca bez roditeljskog staranja; |
| 1.2. fëmijët e abuzuar, neglizhuar dhe keqtrajtuar; | 1.2. abused, neglected and maltreated children; | 1.2. zlostavljena, zapostavljena i maltretirana deca; |
| 1.3. fëmijët me aftësi të kufizuara; | 1.3. children with disabilities; | 1.3. deca sa ograničenim sposobnostima; |
| 1.4. fëmijët e pashoqëruar; | 14. unaccompanied children; | 1.4. deca bez pratnje; |
| 1.5. prind vetë-ushqyes me fëmijë; | 1.5. single parent with children; | 1.5. samohrani roditelji sa decom; |
| 1.6. personat e rritur me aftësi të kufizuar pa përkujdesje familjare; | 1.6. adults with disabilities, without family care; | 1.6. odrasle osobe sa ograničenim sposobnostima bez porodičnog staranja; |
| 1.7. personat e moshuar të vetëm pa përkujdesje familjare; | 1.7. single elderly persons without family care; | 1.7. sama stare osobe bez porodičnog staranja; |
| 1.8. viktimat e trafikimit me njerëz; | 1.8. victims of trafficking in human beings; | 1.8. žrtve trgovine ljudima; |
| 1.9. viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës; | 1.9. Victims of sexual violence during the war; | 1.9. žrtve seksualnog nasilja tokom rata; |
| 1.10. viktimat e dhunës në familje, dhe | 1.10. victims of domestic violence, and | 1.10. žrtve nasilja u porodici, i |

| | | |
|---|---|---|
| 1.11. familjet me fëmijë në varfëri të skajshme.<br><br>2. Natyra e ndihmës dhe mbështetjes përcaktohet në bazë të vlerësimit të rrethanave individuale të secilit rast, duke përfshirë edhe masat specifike të mbështetjes në rast nevoje.<br><br>3. Vlerësimi i nevojave fillestare të GC bëhet në Zyrën Pritëse të Riintegrimit në PKK menjëherë pas arritjes dhe evidentohen në SMR.<br><br>4. Pas arritjes në komunë, vlerësimi i nevojave bëhet nga ekipi multidisiplinar, bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe vizitat në teren.<br><br>5. Ekipi multidisiplinar përgatit planin individual të riintegrimit dhe referon rastin tek organet kompetente për marrjen e shërbimeve.<br><br>6. Institucionet përgjegjëse gjatë procesit të riintegrimit vëmendje të posaçme do t'u kushtojnë edhe personave të riatdhesuar nga institucionet korrektuese, personave të riatdhesuar përdorues të substancave narkotike dhe personave të riatdhesuar me rrethana specifike familjare. | 1.11. families with children in extreme poverty.<br><br>2.Nature of assistance and support shall be determined based on the assessment of individual circumstances of any case, including specific support measures if necessary.<br><br>3.The vulnerable groups' initial needs shall be assessed at the Reception Office in the BCP immediately upon arrival and shall be recorded in CMS.<br><br>4. Upon arrival in the municipality, the multidisciplinary team shall assess the needs based on the available documentation and field visits.<br><br>5.The multidisciplinary team shall prepare the individual reintegration plan and shall refer the case to the competent bodies for receiving services.<br><br>6. During the reintegration process, responsible institutions shall pay special attention to the persons repatriated from correctional institutions, repatriated persons who use narcotic substances and repatriated persons with specific family circumstances. | 1.11. porodice sa decom u krajnjem siromaštvu.<br><br>2.Priroda pomoći i podrške utvrđuje se na osnovu procene pojedinačnih okolnosti svakog slučaja, uključujući i specifične mere podrške u slučaju potrebe.<br><br>3.Procenjivanje početnih potreba UG vrši se u Kancelariji za doček za reintegraciju GP-a odmah po dolasku i evidentira se u SUS-u.<br><br>4. Po dolasku u opštinu, multidisciplinarni tim vrši procenjivanje potreba na osnovu raspoložive dokumentacije i terenskih poseta.<br><br>5. Multidisciplinarni tim priprema individualni plan reintegracije i slučaj prijavljuje nadležnim organima za dobijanje usluga.<br><br>6.Odgovorne institucije tokom procesa reintegracije posebnu pažnju će obratiti repatriranim licima u korektivnim institucijama, repatriranim licima koje koriste narkotičke supstance i repatriranim licima sa specifičnim porodičnim okolnostima. |

| | | |
|---|---|---|
| 7. Vlerësimi i nevojave dhe mbështetja përkatëse udhëhiqet nga parimi i interesit më të mirë të fëmijëve, gjatë tërë procesit të riintegrimit.<br><br>8. Procedura për ripranimin dhe riintegrimin e fëmijëve të pashoqëruar rregullohen me udhëzues të veçantë.<br><br>**Neni 34**<br>**Ndihma dhe mbështetja e personave të riatdhesuar të kthyer nga Zonat e Konfliktit**<br><br>1. Personat e riatdhesuar, të kthyer nga zonat e konfliktit, mbështeten nga skemat përkatëse të riintegrimit, bazuar në nevojat e vlerësuara nga organet kompetente të MPB-së.<br><br>2. Shqyrtimi i kërkesave dhe nevojave të personave të riatdhesuar nga zonat e konfliktit bëhet nga komisioni i themeluar për këtë qëllim.<br><br>3. Komisioni themelohet nga Ministri i MPB-së dhe përbëhet nga përfaqësues të DSP-së, DRPR-së dhe PK/MPB. Anëtarët e Komisionit duhet të kenë përvojë të konsiderueshme të punës dhe ekspertizë në fushat përkatëse të sigurisë dhe riintegrimit. | 7. Needs assessment and relevant support shall be guided by the principle of best interest of the child throughout the reintegration process.<br><br>8. Procedures for readmission and reintegration of unaccompanied children shall be governed with special guidelines.<br><br>**Article 34**<br>**Assistance and support for repatriated persons returned from conflict zones**<br><br>1. Repatriated persons, returned from conflict zones, shall be supported from the relevant reintegration schemes based on the needs assessed by competent bodies of the MIA.<br><br>2. Requests and needs of persons repatriated from conflict zones shall be reviewed by the commission established for this purpose.<br><br>3. Commission shall be established by the Minister of MIA and shall be composed of DPS, DRRP and KP/MIA. Members of the Commission shall have significant work experience and expertise in the relevant fields of security and reintegration. | 7. Procenjivanje potreba i relevantna podrška rukovodi se iz principa najboljeg interesa za decu, tokom celokupnog procesa reintegracije.<br><br>8. Procedura za readmisiju i reintegraciju dece bez pratnje uređuje se posebnim vodičem.<br><br>**Član 34**<br>**Pomoć i podrška repatriranim licima vraćenim iz zona sukoba**<br><br>1. Repatrirana lica, koja su vraćena iz zona sukoba, podržavaju se odgovarajućim šemama reintegracije, na osnovu potreba koje su procenili nadležni organi MUP.<br><br>2. Razmatranje zahteva i potreba repatriranih lica iz zona sukoba razmatra komisija osnovana u ovom cilju.<br><br>3. Komisiju osniva ministar MUP-a i sastavljena je od predstavnika DJB-a, DRRL-a i PK/MUP-a. Članovi komisije moraju imati značajno radno iskustvo i stručnost u relevantnim oblastima bezbednosti i reintegracije. |

| | | |
|---|---|---|
| 4. Komisioni merr vendime me shumicën e votave të anëtarëve prezentë.<br><br>5. Komisioni shqyrton kërkesat, analizon nevojat për masa të veçanta të riintegrimit dhe nxjerr vendimet përkatëse brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e dorëzimit të kërkesës.<br><br>6. Vendimet me dokumentacionin përcjellës dërgohen nga DSPS te DRPR për procedim të mëtejmë për zbatim.<br><br>7. Komisioni shqyrton dhe vendos në harmoni me këtë Rregullore dhe Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.<br><br>8. Riintegrimi i personave të kthyer nga zonat e konfliktit menaxhohet nga MPB në bashkëpunim të ngushtë me agjencitë përkatëse të zbatimit të ligjit dhe institucionet tjera relevante, bazuar në legjislacionin në fuqi.<br><br>**Neni 35**<br>**Kriteret e përgjithshme për përfitim nga skemat specifike të riintegrimit**<br><br>1. Për të përfituar nga skemat e riintegrimit sipas parashtrimit të kërkesës, personat e | 4. Commission shall take decisions with majority of votes of the members present.<br><br>5. Commission shall review requests, analyse the needs for special reintegration measures and shall issue relevant decisions within thirty (30) days from the date of submission of the request.<br><br>6. Decisions with the accompanying documentation shall be submitted by DPS to DRRP for further proceeding for implementation.<br><br>7. Commission shall review and decide in compliance with this Regulation and Law on General Administrative Procedure.<br><br>8. Reintegration of persons returned from conflict zones shall be managed by MIA in close cooperation with relevant law enforcement agencies and other relevant institutions, pursuant to the legislation in force.<br><br>**Article 35**<br>**General criteria for benefiting from specific reintegration schemes**<br><br>1. In order to benefit from reintegration schemes according to the request submitted, | 4. Komisija odlučuje većinom glasova prisutnih članova.<br><br>5. Komisija razmatra zahteve, analizira potrebe za posebnim merama reintegracije i donosi relevantne odluke u roku od trideset (30) dana od dana podnošenja zahteva.<br><br>6. Odluke sa pratećom dokumentacijom DJB prosleđuju DRRL-u za dalje procesiranje u sprovođenju.<br><br>7. Komisija razmatra i odlučuje u skladu sa ovom uredbom i Zakonom o opštem upravnom postupku.<br><br>8. Reintegracijom repatriranih lica vraćenih iz zona sukoba upravlja MUPJU u bliskoj saradnji sa relevantnim agencijama za sprovođenje zakona i drugim relevantnim institucijama, na osnovu važećeg zakonodavstva.<br><br>**Član 35**<br>**Opšti kriterijumi za ostvarivanje koristi od specifičnih šema reintegracije**<br><br>1. Za ostvarivanje koristi od šema reintegracije, |

| | | |
|---|---|---|
| riatdhesuar duhet t'i plotësojnë kriteret e përgjithshme si në vijim:<br><br>1.1. të jetë i riatdhesuar;<br><br>1.2. të ketë jetuar së paku një vit (1) pa ndërprerë jashtë Kosovës;<br><br>1.3. të ketë dorëzuar kërkesën, brenda tre (3) muajve nga data e riatdhesimit, për përfitim nga masat emergjente të riintegrimit dhe /ose brenda gjashtë (6) muajve për përfitim nga masat e riintegrimit të qëndrueshëm;<br><br>1.4. të mos jetë i riatdhesuar për herë të dytë ose më shumë;<br><br>1.5. të mos ketë përfituar nga ndonjë skemë e njëjtë prej organizatave vendore ose ndërkombëtare. | the repatriated persons shall meet the general criteria, as follows:<br><br>1.1.be repatriated;<br><br>1.2.have lived for an uninterrupted period of at least one (1) year outside Kosovo;<br>1.3.have submitted the request within three (3) months from the date of repatriation to benefit from emergency reintegration measures and/or within six (6) months to benefit from measures of sustainable reintegration;<br><br>1.4.not be repatriated for the second time or more;<br><br>1.5.not have benefited from any similar scheme of domestic or international organizations. | repatrirana lica moraju ispuniti sledeće opšte kriterijume:<br><br>1.1.da je repatriran;<br><br>1.2.da je živeo najmanje jednu (1) godinu bez prekida izvan Kosova;<br><br>1.3.da je podneo zahtev, u roku od tri (3) meseca od dana repatrijacije, za ostvarivanje koristi od hitnih mera reintegracije i u roku od šest (6) meseci od dana repatrijacije za ostvarivanje koristi od šema za održivu reintegraciju.<br><br>1.4.da nije repatrirani po drugi put ili više;<br><br>1.5.da nisu ostvarili korist od bilo koje slične šeme domaćih ili međunarodnih organizacija; |
| 2. Përjashtim nga paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 i këtij neni, bëjnë përfitimet e përcaktuara në nenin 30 të kësaj rregullore. | 2. Benefits determined in Article 30 of this Regulation shall be exempted from paragraph 1, subparagraph 1.2 of this Article. | 2. Iz stava 1. tačka 1.2 ovog člana, izuzimaju se koristi utvrđene u članu 30. ove uredbe. |
| 3.Përjashtimi nga paragrafi 2 i këtij neni, nuk aplikohet për rastet e përcaktuara në nenin 33 dhe 34 të kësaj rregullore. | 3.Exemption from paragraph 2 of this Article shall not be applied to cases determined in Article 33 and 34 of this Regulation. | . 3.Iz stava 2. ovog člana, izuzima se primena za određene slučajeve u članu 33. i 34. ove uredbe. |

| KAPITULLI III<br>MENAXHIMI, KOORDINIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI<br><br>Neni 36<br>Institucionet përgjegjëse | CHAPTER III<br>MANAGEMENT, COORDINATION, MONITORING AND ASSESSMENT<br><br>Article 36<br>Responsible institutions | POGLAVLJE III<br>UPRAVLJANJE, KOORDINACIJA, PRAĆENJE I PROCENA<br><br>Član 36<br>Odgovorne institucije |
|---|---|---|
| 1. MPB, përkatësisht DRPR, është përgjegjëse për hartimin, koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave të riintegrimit në bashkëpunim të ngushtë me institucionet relevante qendrore dhe lokale. | 1. MIA, namely DRRP, shall be responsible for drafting, coordinating, monitoring and assessing the reintegration policies in close cooperation with relevant central and local institutions. | 1. MUP, odnosno DRRL je odgovorno za izradu, praćenje i koordinaciju politika reintegracije u bliskoj saradnji sa relevantnim centralnim i lokalnim institucijama. |
| 2. Secila nga ministritë relevante dhe komunat, bazuar në mandatin e tyre, përcaktojnë masat për riintegrim, si pjesë të planit operativ dhe financiar për zbatim të politikave të riintegrimit. | 2. Each of relevant ministries and municipalities, based on their mandate, shall determine measures for reintegration as part of the operational and financial plan for implementing reintegration policies. | 2. Svako od relevantnih ministarstava i opština, na osnovu svog mandata, postavlja mere reintegracije, kao deo operativnog i finansijskog plana za sprovođenje politika reintegracije. |
| 3. Të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e kësaj rregullore, duhet të sigurojnë dhe përditësojnë materialet me informata të nevojshme për riintegrim. | 3. All institutions responsible for implementation of this Regulation shall provide and update materials with information necessary for reintegration. | 3. Sve institucije koje su odgovorne za sprovođenje ove uredbe, trebaju obezbediti i ažurirati materijal sa potrebnim informacijama za reintegraciju. |
| 4. Ministritë dhe drejtoritë komunale relevante duhet të caktojnë zyrtarët përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve të riintegrimit me MPB/DRPR-në. | 4. Relevant ministries and municipal departments shall assign officers responsible for coordination of reintegrationactivities with MIA/DRRP. | 4. Relevantna ministarstva i opštinska odeljenja moraju da odrede službenike odgovorne za koordinacione aktivnosti reintegracije sa MUP/DRRL-om. |
| 5. Monitorimin e zbatimit të politikave të riintegrimit në nivel lokal e bën MPB/ DRPR në bashkëpunim të ngushtë me MPL. | 5. MIA/DRRP, in close cooperation with MLG, shall monitor the implementationof the reintegration policies at the local level. | 5. Praćenje sprovođenja politike reintegracije na lokalnom nivou obavlja MUP/ DRRL u saradnji sa MLS-om. |

| Neni 37<br>Roli i Ministrisë së Punëve të Brendshme në procesin e riintegrimit | Article 37<br>Role of the Ministry of Internal Affairs in the reintegration process | Član 37<br>Uloga Ministarstva unutrašnjih poslova i u procesu reintegracije |
|---|---|---|
| 1. MPB, përkatësisht DRPR, është përgjegjëse për: | 1. MIA, namely DRRP, shall be responsible for: | 1. MUP, konkretno DRRL je odgovorno za: |
| 1.1. zhvillimin e përgjithshëm të politikave, menaxhimin dhe koordinimin e riintegrimit të personave të riatdhesuar; | 1.1. overall policy development, and management and coordination of repatriated persons' reintegration; | 1.1. ukupan razvoj politika, upravljanje i koordinacija reintegracije repatriranih lica; |
| 1.2. përcaktimin e masave legjislative dhe buxhetore për mbështetjen e riintegrimit; | 1.2. determining legislative and budget measures for supporting the reintegration; | 1.2. utvrđivanje zakonodavnih i budžetskih mera za podršku reintegracije; |
| 1.3. monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të politikave të riintegrimit; | 1.3. monitoring and assessing the implementation of reintegration policy; | 1.3. praćenje i procenu sprovođenja Strategije za reintegraciju; |
| 1.4. ngritjen e kapaciteteve të institucioneve relevante për riintegrim të personave të riatdhesuar; | 1.4. building capacities of relevant institutions for reintegration of repatriated persons; | 1.4. podizanje kapaciteta relevantnih institucija za reintegraciju repatriranih lica; |
| 1.5. bashkëpunimin me institucionet relevante, organizatat vendore e ndërkombëtare dhe koordinon donacionet për fushën e riintegrimit. | 1.5. cooperation with relevant institutions, domestic and international organizations and coordinating donations in the field of reintegration. | 1.5. saradnju sa relevantnim institucijama, domaćim i međunarodnim organizacijama i koordinaciju u oblasti reintegracije. |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 38**<br>**Financimi i masave të riintegrimit**<br><br>1. Buxheti i riintegrimit sigurohet çdo vit me ligjin vjetor të buxhetit.<br><br>2. MPB është autoriteti përgjegjës për menaxhimin e buxhetit të riintegrimit.<br><br>3. Shpenzimet kryhen në harmoni me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive, Ligjin për Prokurim Publik, Rregullat e Thesarit dhe udhëzimet administrative të lëshuara nga Ministria e Financave (MF).<br><br>4. Një pjesë e buxhetit të riintegrimit mund të ndahet për ministritë relevante, komunat dhe/ose organizatat për financimin e masave specifike të riintegrimit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.<br><br>5. Buxheti ndahet përmes përfitimeve dhe mbështetjes siç specifikohet me këtë rregullore.<br><br>**Neni 39**<br>**Sistemi i Menaxhimit të Rasteve (SMR)**<br><br>1. Sistemi i Menaxhimit të Rasteve është sistem elektronik i cili administrohet nga MPB, në të cilin regjistrohen, ruhen, | **Article 38**<br>**Funding of reintegration measures**<br><br>1. Reintegration budget shall be allocated on annual basis with annual budget law.<br><br>2. MIA shall be the authority responsible for managing the reintegration budget.<br><br>3. Spending shall be made in compliance with the Law on Public Financial Management and Accountability, Law on Public Procurement, Treasury Rules and Administrative Instructions issued by the Ministry of Finance (MF).<br><br>4. A share of the reintegration budget may be allocated to relevant ministries, municipalities and/or organizations for funding specific reintegration measures, according to the relevant applicable legislation.<br><br>5. Budget shall be allocated through benefits and support as specified in this Regulation.<br><br>**Article 39**<br>**Case Management System (CMS)**<br><br>1. Case Management System shall be the electronic system administered by MIA where requests and other relevant data | **Član 38**<br>**Finansiranje mera reintegracije**<br><br>1. Budžet za reintegraciju obezbeđuje se svake godine zakonom o godišnjem budžetu.<br><br>2. MUP je organ koji je odgovoran za upravljanje budžetom reintegracije.<br><br>3. Troškovi se usklađuju Zakonom o upravljanju javnim finansijama i odgovornostima, Zakonom o javnim nabavkama, Propisima trezora, administrativnim uputstvima i izdatim od strane Ministarstva finansije (MF).<br><br>4. Deo budžeta za reintegraciju može se dodeliti nadležnim ministarstvima,opštinama i/ili organizacijama za finansiranje određenih mera reintegracije, u skladu sa važećim zakonodavstvom.<br><br>5. Budžet se izdvaja kroz ostvarivanje koristi i pomoći kao što je navedeno u ovoj uredbi.<br><br>**Član 39**<br>**Sistem za upravljanje slučajevima (SUS)**<br><br>1. Sistem za upravljanje slučajevima je elektronski sistem kojim upravlja MUP u koji se beleže, čuvaju, obrađuju i arhiviraju |

| | | |
|---|---|---|
| procedohen dhe arkivohen kërkesat dhe të dhënat e tjera relevante për personat e riatdhesuar dhe përfitimet e tyre. | regarding reintegrated persons and their benefits shall be recorded, stored, processed and archived. | zahtevi i drugi relevantni podaci koji se odnose na repatrirana lica i njihove olakšice. |
| 2. Përmes SMR-së menaxhohet tërë procesi i riintegrimit të personave të riatdhesuar nga momenti i hyrjes në Kosovë, deri në mbylljen e rastit. SMR shërben si mjet për monitorimin dhe vlerësimin e rasteve. | 2. Whole process of reintegration of repatriated persons shall be managed through CMS from the moment of their entry in Kosovo until the closure of the case. CMS shall serve as a tool for monitoring and evaluation of cases. | 2. Preko SUS-a upravlja se celokupnim procesom reintegracije repatriranih lica od trenutka ulaska na Kosovo, do zatvaranja slučaja. SUS služi kao sredstvo za praćenje i procenu slučaja. |
| 3. Të dhënat e personave të riatdhesuar trajtohen në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. | 3. Data of repatriated persons shall be treated in line with the Law on Protection of Personal Data. | 3. Podaci repatriranih lica tretiraju se u skladu sa Zakonom o zaštiti ličnih podataka. |
| 4. Rregullat e qasjes dhe menaxhimit të dhënave në SMR do të përcaktohen nga MPB me akt të veçantë nënligjor. | 4. Rules of access and management of data in CMS shall be determined by MIA with a special bylaw. | 4. Pravila pristupa i upravljanja podacima u SUS-u utvrđuje MUP posebnim podzakonskim aktom. |
| **Neni 40**<br>**Komisioni për Ankesa** | **Article 40**<br>**Commission for Appeals** | **Član 40**<br>**Žalbena komisija** |
| 1. Komisioni për Ankesa është organ i cili shqyrton dhe vendos për ankesat e personave të riatdhesuar kundër vendimeve të KKR-së. | 1. Commission for Appeals shall be the body reviewing and deciding on appeals of repatriated persons against decisions of MRC. | 1. Žalbena komisija je organ koji razmatra i odlučuje o žalbama repatriranih lica na odluke OKR-a. |
| 2. Komisioni për Ankesa themelohet nga MPB-ja me mandat tre (3) vjeçar, me mundësi vazhdimi edhe për një mandat tjetër. | 2. Commission for Appeals shall be established by MIA with a three (3) year mandate, with the possibility of extension for another mandate. | 2. Žalbenu komisiju osniva MUP za period od tri (3) godine sa mogućnošću produženja za još jedan mandat. |

| | | |
|---|---|---|
| 3. KA përbëhet nga kryesuesi, zv. kryesuesi dhe tre (3) anëtarë, të cilët duhet të jenë përfaqësues nga DRPR dhe Departamenti Ligjor/MPB.<br><br>4. Anëtarët e Komisionit duhet të jenë juristë me përvojë të konsiderueshme të punës. Së paku dy (2) nga anëtarët e komisionit duhet të kenë ekspertizë në fushat e riintegrimit.<br><br>5. KA merr vendime me shumicën e votave të anëtarëve prezentë. Kuorumi duhet të jetë së paku prej tre (3) anëtarëve të komisionit.<br><br>6. KA shqyrton ankesën dhe nxjerr vendim brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e dorëzimit të ankesës.<br><br>7. Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës nga DRPR përmes ZKKK.<br><br>8. KA shqyrton dhe vendos në harmoni me kriteret e përcaktuar me këtë Rregullore dhe Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative. | 3. CA shall be composed of the chair, deputy chair and three (3) members, who shall be representatives of DRRP and Legal Department/MIA.<br><br>4. Members of the Commission must be lawyers with considerable experience. At least two (2) of commission members shall represent a high expertise in various reintegration fields.<br><br>5. CA shall take decisions with a majority of votes of members present. The quorum shall consist at least of three (3) members of the Commission.<br><br>6. CA shall review the appeal and issue the decision within thirty (30) days from the date of submission of the appeal.<br><br>7. Decision shall be submitted to the appellant by the DRRP through the MOCR.<br><br>8. CA shall review and decide in line with the criteria determined in this Regulation and Law on General Administrative Procedure. | 3. ŽK se sastoji od predsednika, zamenika predsednika i tri (3) člana, koji treba da budu predstavnici DRRL-a i Pravnog departmana/MUP.<br><br>4. Članovi Komisije moraju biti advokati sa značajnim radnim iskustvom. Najmanje dva (2) člana Komisije predstavljaće visoku stručnost u različitim oblastima reintegracije.<br><br>5. ŽK donosi odluke većinom glasova prisutnih članova. Kvorum mora biti od najmanje tri (3) člana Komisije.<br><br>6. ŽK razmatra žalbu i donosi odluku u roku od trideset (30) dana od dana dostavljanja žalbe.<br><br>7. Odluka se dostavlja podnosiocu žalbe od strane DRRL-a preko OKPZ-a,<br><br>8. ŽK razmatra i odlučuje u skladu sa kriterijumima ove Uredbe i Zakonu o opštem upravnom postupku. |

| KAPITULLI IV<br>PROCEDURAT PËR PËRFITIM | CHAPTER IV<br>PROCEDURES FOR BENEFITING | POGLAVLJE IV<br>PROCEDURE ZA OSTVARIVANJE KORISTI |
|---|---|---|
| **Neni 41**<br>**Procedurat e aplikimit** | **Article 41**<br>**Application procedures** | **Član 41**<br>**Procedure apliciranja** |
| 1. Personi i riatdhesuar parashtron kërkesën për përfitim nga masat e veçanta të riintegrimit, në ZKKK në komunën e tij të origjinës. | 1. The repatriated person shall submit to the MOCR, in his/her municipality of origin, the application for benefiting from special reintegration measures. | 1. Repatrirano lice podnosi zahtev za ostvarivanje koristi od posebnih mera reintegracije, u OKPZ u svojoj matičnoj opštini. |
| 2. ZKKK ofron informata dhe udhëzime për dokumentacionin e nevojshëm dhe plotësim të formularit apo kërkesës për përfitim. | 2. MOCR shall provide information and guidelines regarding the necessary documentation and filling in the form or request for benefiting. | 2. OKPZ pruža informacije i smernice o potrebnoj dokumentaciji i popunjavanju obrasca ili zahteva za ostvarivanje koristi. |
| 3. ZKKK pranon kërkesat e parashtruara, sigurohet se ato janë të kompletuara, bën verifikimin e gjendjes, regjistron kërkesën në SMR dhe i procedon ato për vendimmarrje në KKR. | 3. The MOCR shall receive the requests submitted, to make sure that those requests are complete, verify the situation, record the request in CMS and forward them for decision-making in MRC. | 3. OKPZ prima podnesene zahteve, osigurava da su kompletirani, proverava stanje, registruje zahtev u SUS i obrađuje ih za odlučivanje u OKR-u. |
